



# GSRM

## KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

**Material Infomues**

## **INFORMACIONI MBI KOMISIONET PËR VEPRIMET E LETRAVE ME VLERË QË**

### **APLIKOHEN NGA Posta Shqiptare.sh.a**

Posta Shqiptare si “Shoqëri brokerimi në letrat me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në Bursë dhe në tregun me pakicë” ushtron veprimtarinë e tregtimit të titujve (blerje/shitje) nëpërmjet marrjes dhe ekzekutimit të porosive të klienteve.

Nëse një klient blen letra me vlerë të Qeverisë në tregun primar nëpërmjet Postës Shqiptare, komisioni që aplikohet për individët është 0.1% e shumës (min 300 lekë, max 1,000 lekë) pavarësisht nga shuma e investuar. Për shitjen e letrave me vlerë të Qeverisë nga Portofoli i Postës Shqiptare në tregun sekondar nuk aplikohet komision. Në këtë rast klientit do t’i llogaritet çmimi i shitjes së letrës me vlerë të Qeverisë në bazë të yieldit të shitjes të kuotuar nga banka për ditët e mbetura deri në maturim të letrës me vlerë.

#### **Shembull:**

Një klient do të investojë pranë Postës Shqiptare, një shumë prej 1,000,000 lekë në një Bono Thesari 12 mujore, të cilës i kanë mbetur 120 ditë deri në maturim, duke pasur parasysh që yield-i në shitje i kuotuar nga banka është 6.80%, çmimi i shitjes llogaritet si më poshtë:

$$\text{Çmimi i shitjes} = \frac{1,000,000}{1 + (6.4\% * 120 / 365)}$$

**Çmimi = 979,432 lekë**

Në rastin kur klienti dëshiron të shesë një letër me vlerë të Qeverisë, pranë Postës Shqiptare, para datës së maturimit dhe në se ditët e mbetura deri në maturim janë më shumë se 7 ditë, atëherë nuk aplikohet komision. Në këtë rast, çmimi i blerjes së letrës me vlerë të Qeverisë do të llogaritet në bazë të yield-it të blerjes së kuotuar nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

#### **Shembull:**

Një klient do të shesë një Bono Thesari me maturim 12 mujor me vlerë nominale 1,000,000 lekë. Ditët e mbetura deri në maturim janë 110 ditë. Në rast se yield-i është 7.2 %, çmimi i blerjes në këtë rast do të llogaritet në bazë të ditëve të mbetura deri në maturim dhe do të jetë:

**Çmimi i blerjes = 955,405 lekë**